



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2018

PËR

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA DHE
NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 006, DATË 23.10.2008 “PËR
MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

VENDOSI:

Propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar”, sipas tekstit dhe relacionin shoqërues, raportin e vlerësimit të ndikimit (RIA) dhe tabelat e përputhshmërisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 10006, DATË 23.10.2008
“PËR MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Emërtimi i ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshohet si më poshtë:
“Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër”.

Neni 2

1. “Kudo në tekstin e këtij ligji, përjashtuar nenin 45, në të cilin përcaktohet ndryshe, emërtimet “Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve” zëvendësohet me “agjencinë përgjegjëse për monitorimin e mjedisit”, “Policia Pyjore” zëvendësohet me emërtimet “struktura inspektuese që mbulon fushën e pyjeve” dhe “drejtoria e shërbimit pyjor” zëvendësohet me “struktura përgjegjëse për mbrojtjen e faunës së egër në njësinë përkatëse të qeverisjes vendore”.

¹ Ky ligj është i përafëruar me Direktivën 92/43/EEC “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër” të ndryshuar, si dhe me Direktivën 2009/147/EC “Për konservimin e shpendëve të egër”.

2. Kudo në tekstin e këtij ligji, ligji nr. 8405, datë 17.9.1998 "Për substancat dhe preparatet kimike", zëvendësohet me togfjalëshin "legjislacionin në fuqi për menaxhimin e kimikateve"; ligji nr.9537, datë 18.5.2006 "Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme", zëvendësohet me togfjalëshin "legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbetjeve të integruar të mbetjeve"; ligji nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, zëvendësohet me togfjalëshin "legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura"; ligji nr.7908, datë 5.4.1995 "Për peshkimin dhe akuakulturën", të ndryshuar, zëvendësohet me togfjalëshin "legjislacionin në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën".

Neni 3

Në nenin 1, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Ky ligj ka për qëllim konservimin e faunës së egër, mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e saj, me synimin për të siguruar llojet, popullatat, habitatet ku kjo faunë e egër jeton, si dhe për të plotësuar kërkesat e saj për ushqim, strehim dhe shumim duke siguruar në të njëjtën kohë dhe rrugët e saj të shtegtimit".

2. Pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

"3. Përmes këtij ligji synohet:

- ruajtja ose rivendosja në gjendje të favorshme të habitateve natyrore dhe llojeve të faunës së egër me interes për komunitetin europian;
- sigurimi i vlerësimit të gjendjes së biodiversitetit në Shqipëri dhe të mekanizmave për monitorimin e kësaj gjendje;
- krijimi i një sistemi, me qëllim mbrojtjen dhe konservimin afatgjatë të karakteristikave të cilat do të shërbejnë si baze për përcaktimin e zonave potenciale për t'u shpallur zona të mbrojtura;
- sigurimi i një kuadri ligjor dhe institucional për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, për të mirën e brezave të sotëm dhe të ardhshëm, duke minimizuar degradimin e habitateve dhe shqetësimet ndaj llojeve, që të ndikojnë në arritjen e statusit të tyre të favorshëm të ruajtjes;
- kontributi në konservimin e gjendjes natyrore të tokës, në konservimin e cilësisë, sasisë dhe disponueshmërisë së ujit, mirëmbajtjen e atmosferës, prodhimin e oksigjenit dhe mirëmbajtjen e klimës."

Neni 4

Në nenin 2, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. "Konservim" është tërësia e masave të ndërmarra për të mirëmbajtur ose rivendosur, për një afat të gjatë kohor, në një status të favorshëm ruajtjeje habitatet natyrore dhe popullatat e llojeve të florës dhe faunës së egër."

2. Pas pikës 2, shtohen pikat 2/2 dhe 2/3, me këtë përmbajtje:

"2/2. "Zonë " është një zonë e përcaktuar gjeografike, shtrirja e së cilës përshkruhet me hollësi.

2/3. "Statusi i gjendjes së një lloji, ekosistemi, habitati apo peizazhi" është gjendja e popullatave të llojit, ekosistemit, habitatit ose peizazhit që vjen nga tërësia e faktorëve që veprojnë mbi to."

3. Pas pikës 9, shtohet pikat 9/1 me këtë përmbajtje:

"9/1. "Status i favorshëm ruajtjeje për një lloj" është kur:

- a) të dhënat dinamike të popullatës për një lloj me interes tregojnë që ai ngelet për një kohë afatgjatë një përbërës i vlefshëm dhe i aftë i habitateve të tij natyrore;
- b) përhapja natyrore e llojeve nuk është pakësuar dhe nuk ka gjasa të pakësohet në të ardhmen e afërt;
- c) gjendet dhe me shumë gjasa do të vazhdojë të jetë një habitat i përshtatshëm, nga ana e përmasave, për të mbajtur popullatën për një kohë të gjatë."

6. Pas pikës 12, shtohet pika 12/1 me këtë përmbajtje:

"12/1. "Monitorimi" është mbikëqyrja e përcaktuar mirë dhe në mënyrë sistematike e gjendjes së natyrës ose përbërësve të diversitetit biologjik dhe të peizazhit."

7. Pas pikës 17, shtohet pika 18 me këtë përmbajtje:

"18. "Komisioni" është Komisioni i Bashkimit Evropian".

Neni 5

Në nenin 5, pas shkronjës d), shtohet shkronja dh) me këtë përmbajtje:

"dh) Mirëmbajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje të habitateve natyrore dhe të llojeve të faunës së egër me interes për komunitetin evropian."

Neni 6

Në nenin 6 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Sigurimi i rivendosjes dhe mirëmbajtjes së statusit të favorshëm të ruajtjes për faunën e egër, si dhe sigurimi i mbrojtjes së veçantë për llojet e saj, në përputhje me gjendjen konkrete të llojeve dhe të habitateve ku jetojnë, duke u dhënë status të veçantë mbrojtjeje:

- a) llojeve të kërcënuara e në rrezik zhdukjeje;
- b) llojeve që kërkojnë vëmendje të veçantë për arsye të natyrës specifike të habitatit të tyre."

Neni 7

Pas nenit 6, shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 6/1

Masat e mbrojtjes për zonat me interes për komunitetin evropian

1. Masat specifike të ruajtjes zbatohen në përputhje me planet e menaxhimit, planet zhvillimore dhe detyrimet ligjore ose kontraktuale, që korrespondojnë me kërkesat ekologjike

të tipeve të habitatit natyror, pas shpalljes së një zone si zonë me interes për komunitetin europian.

2. Çdo plan ose projekt që nuk lidhet drejtpërdrejt, por mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në zonën me interes për komunitetin europian, i nënshtrohet procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Autoritetet

kompetente miratojnë planin ose projektin, vetëm pasi të konstatohet në raportin e vlerësimit të ndikimit për zonën dhe llojet, se ai nuk do të ndikojë negativisht në integritetin e zonës në fjalë dhe vetëm pas marrjes së mendimit të publikut të gjerë.

3. Në rastet kur një plan apo projekt duhet të realizohet për arsye të interesit publik, pavarësisht ndikimit negativ në zonën dhe llojet dhe, në mungesë të zgjidhjeve alternative, miratohen masa kompensuese. Këto masa përcaktohen me urdhër të ministrit, me qëllim sigurimin e koherencës së përgjithshme të rrjetit të zonave me rëndësi për komunitetin europian. Komisioni informohet për masat kompensuese të miratuara.”.

Neni 8

Në nenin 7, pas pikës 2, shtohet pikat 3 me këtë përmbajtje:

“3. Ministria, në bashkëpunim me organet e qeverisjes qendrore e vendore, institute të specializuara, organizata jofitimprurëse dhe me persona fizikë e juridikë, harton planet e veprimit për ruajtjen e llojeve të kërcënuara dhe endemike. Planet miratohen me urdhër të ministrit.”.

Neni 9

Në nenin 8, pas pikës 3, shtohet pikat 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

“4. Për ekosistemet, habitatet, si dhe për llojet e faunës së egër me status mbrojtje, që ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, hartohen plane menaxhimi, që miratohen me urdhër të Ministrit.

5. Kriteret për hartimin e planeve të menaxhimit si dhe për përcaktimin e ekosistemeve, habitateve dhe llojeve të faunës së egër me status mbrojtjeje, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për mbrojtjen e faunës.”.

Neni 10

Në nenin 10, titulli dhe pika 1, ndryshohen si më poshtë:

“Neni 10

Mbrojtja nga lëndët, mbetjet e rrezikshme dhe shërbimet

1. Për të shmangur efektet e rënda negative mbi faunën e egër dhe mbi tërësinë gjenetike të saj, mbi habitatet, rrugët e shtegtimit dhe kushtet e shumimit, përdorimi dhe administrimi i lëndëve dhe i mbetjeve të rrezikshme, i kimikateve bujqësore, veterinare dhe shërbimeve bëhen në përputhje me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi, që lidhet me substancat dhe preparatet kimike, administrimin e mbetjeve të rrezikshme, shërbimin e mbrojtjes së bimëve, shërbimin veterinar, si dhe duke marrë në konsideratë edhe çështjet specifike, që lidhen me parandalimin e helmimit të shpendëve shtegtarë, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në marrëveshjet në të cilat vendi ynë është palë.”.

Neni 11

Në nenin 13, pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Masat e marra për të siguruar mbrojtjen e llojeve në vendet e ruajtjes, duke përfshirë mirëmbajtjen e popullatave të llojeve të përmendura në pikën 1 të këtij neni, në një nivel të përputhshëm me kërkesat ekologjike dhe shkencore, realizohen duke mbajtur parasysh edhe kërkesat ekonomike, sociale dhe kulturore, si edhe veçoritë rajonale e lokale."

Neni 12

Në nenin 14, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1, ndryshohet si më poshtë:

"1. Për shpendët e egër që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për shpendët shtegtarë, ndërmerren masa me qëllim ruajtjen, mirëmbajtjen ose për të rivendosur një diversitet dhe habitat të mjaftueshëm, nëpërmjet:

a) krijimit të zonave të mbrojtura mjedisore, sipas dispozitave të kuadrit ligjor për zonat e mbrojtura, si dhe kuadrit nënligjor që lidhet me miratimin e rregullave për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes;

b) sigurimit dhe menaxhimit të habitateve, brenda dhe jashtë zonave të mbrojtura mjedisore, në bazë të nevojave ekologjike;"

c) krijimit të biotopeve dhe rivendosjes së biotopeve të shkatërruara.

2. Pika 4, ndryshohet si më poshtë:

"4. Zonat veçanërisht të mbrojtura për shpendët shpallen sipas dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi për zonat e mbrojtura."

Neni 13

Në nenin 16, pas pikës 2, shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

"3. Rregullat për paraqitjen e kërkesës, dokumentet shoqëruese, kriteret që duhen përmbushur për dhënie në përdorim të sipërfaqeve për krijimin e qendrave të shpëtimit, procedura e miratimit apo refuzimit të kërkesës, si dhe procedura e miratimit të rregullores së organizimit dhe funksionimit të qendrës së shpëtimit përcaktohen me udhëzim të ministrit."

Neni 14

Në nenin 19, pas pikës 9, shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

"10. Përdorimi i karremeve helmuese për asgjësimin e llojeve të faunës së egër."

Neni 15

Në nenin 33, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Procesi i inventarizimit koordinohet dhe mbikqyret nga ministria, me pjesëmarrjen e AKZM, strukturave përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, të instituteve kërkimore-shkencore, të OJF-ve e të shoqatave që mbulojnë fushën e biodiversitetit."

Neni 16

Në nenin 35, pas paragrafit të parë, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

"3. Ministria koordinon dhe mbikqyr-monitorimin e llojeve të faunës së egër dhe habitateve të tyre, përfshirë monitorimin e kapjeve apo vrasjeve aksidentale të llojeve të faunës me interes për komunitetin europian, në përputhje me kuadrin nënligjor që lidhet me miratimin e listave të tipeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve me interes për komunitetin europian."

Neni 17

Pas nenit 35, shtohet neni 35/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 35/1

Këshilli Kombëtar i Faunës së Egër

1. Pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit ngrihet Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër si një organ konsultativ, për të kontribuar në lehtësimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore.

2. Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër drejtohet nga zëvendësministri i ministrisë përgjegjëse për faunën e egër dhe ka në përbërjen e tij:

a) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen e faunës;

b) përfaqësues nga ministrinë e linjës, fusha e përgjegjësisë të të cilave lidhet me mbrojtjen e faunës;

c) organizatat jo fitimprurëse mjedisore të fushës së faunës së egër dhe biodiversitetit;

d) federatat dhe shoqatat e gjuetarëve,

e) universitetet dhe institucionet kërkimore-shkencore.

3. Këshilli Kombëtar për Faunën e Egër këshillon dhe kontribuon në hartimin e:

a) programit të inventarizimit të faunës së egër;

b) programeve për zhvillimin e faunës së egër;

c) planeve vjetore të mbarështimit të faunës së egër;

d) projekteve për zhvillimin e faunës së egër;

e) kalendarit të gjuetisë;

f) listës së specieve objekt gjuetie për çdo sezon gjuetie;

g) përcaktimin e kuotave vjetore për speciet objekt gjuetie."

4. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar për Faunën e Egër përcaktohet në rregulloren e miratuar me urdhër të ministrit.

Neni 18

Në nenin 37, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Metodatat, kriteret dhe procedurat për grumbullimin, regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave për faunën e egër miratohen me udhëzim të ministrit. Të dhënat duhet të përfshijnë edhe informacionin mbi aspektet sociale, ekonomike dhe mjedisore të kafshëve të egra dhe

ndikimin mbi banorët lokalë. Personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, paraqesin të dhënat brenda 30 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, të cilat shoqërohen edhe me shpjegime për interpretimin e tyre, si dhe me rekomandime për zgjidhjen e problemeve.”

Neni 19

Në pikën 1 të nenit 39, pas togfjalëshit “...e faunës së egër...” shtohet togfjalëshi “...dhe për statusin e saj të ruajtjes...”

Neni 20

Në nenin 43, pika 12 ndryshohet si më poshtë:
“12. Shfarosja e llojeve të faunës së egër dhe e popullatave të tyre, në kundërshtim me dispozitat e pikave 7 dhe 10 të nenit 19 të këtij ligji, me gjobë, në masën 100 000 deri në 200 000 lekë.”

Neni 21

Në nenin 44, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:
“3. Individët e konfiskuar apo te sekuestruar dorëzohen në qendrat e shpëtimit.”

Neni 22

Hyrja në fuqi
Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I KUVENDIT

GRAMOZ RUÇI

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN Nr. 10 006,
DATË 23.10.2008 “PËR MBROJTJEN E FAUNËS SË EGËR”, TË
NDRYSHUAR”**

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar” ka si qëllim që të bëjë disa ndryshime e plotësime në ligjin aktual të sipërcituar të faunës së egër nr. 10006/2008, të ndryshuar, në mënyrë që të adresohen ndryshimet e ndodhura si pasojë e reformës territoriale, ndryshimet në menaxhimin e pyjeve dhe organeve respektive të shërbimit pyjor në nivel vendor të vitit 2016, si dhe të reflektohet avancimi me transpozimin e dy direktivave të fushës së mbrojtjes së natyrës, Direktivës 92/43/EEC “Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër”, të ndryshuar dhe të Direktivës “Për Ruajtjen e Shpendëve të Egër” nr. 2009/147/EC të Bashkimit Evropian.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në një linjë me kërkesat e programit të Qeverisë, që e konsideron mbrojtjen e mjedisit si një detyrë të rëndësishme e të përbashkët për të gjithë dhe është i përfshirë në programin e akteve të Këshillit të Ministrave, që duhet të miratohen brenda vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar”, rrit shkallën e

Relacion shpjegues për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 “Për mbrojtjen e faunës së egër”, të ndryshuar”

përafrit me Direktivat "Për ruajtjen e shpëndëve të egër" nr. 2009/147/EC Direktivës të BE dhe 92/43/EEC "Për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të florës e faunës së egër", të ndryshuar.

Drafti i projektligjit u hartua me asistencën e projektit GEF/UNDP për sistemin e monitorimit mjedisor, draft i cili u shqyrtua dhe diskutua në disa tavolina të rumbullakta me ekspertët e projektit, OJF dhe ekspertë të fushës së mbrojtjes së natyrës si dhe punonjës të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM). Drafti u trajtua pas kësaj nga drejtoritë përkatëse të MTM. Në hartimin e draftit janë marrë si model ligje të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian.

Më tej, në dëgjesën me publikun që u organizua më datë 31.10.2018 në ambientet e MTM, si dhe në komentet që u dërguan në mënyrë shkresore brenda datës 8.11.2018, u paraqitën një numër komentesh e sugjerimesh, që janë përfshirë në një masë të konsiderueshme në këtë draft që po paraqitet për shqyrtim. Lidhur me sugjerimin e dhënë nga tre shoqata mjedisore - Shoqata e Ornitologëve të Shqipërisë, Shoqata për Ruajtjen e Shpëndëve dhe Gjitarëve të Shqipërisë, si dhe Shoqata e Ruajtjes dhe e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (respektivisht AOS, ASPBM dhe PPNEA), për parashikimin e një dispozite ku të përcaktohet zëvendësimi i gjuetisë me municion plumbi me gjuetinë me municion jotoksik, sqarojmë se ky parashikim do të mbahet në konsideratë në amendimet që parashikohen të bëhen në Ligjin nr. 10253, datë 11.3.2010 "Për gjuetinë", të ndryshuar.

Nëpërmjet ligjit nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar, u hodh hapi i parë i rëndësishëm për transpozimin e dy direktivave të sipërcituar. Ndryshimet dhe plotësimet që po paraqiten tani, do të bëjnë të mundur që të kemi një kuadër dhe më të plotë që do sigurojë konservimin, mbrojtjen, menaxhimin dhe kontrollin e faunës së egër në vendin tonë.

Nga ana tjetër, projektligji do të kontribuojë në përmbushjen e masave në zbatim të "Planit Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE)", në të cilin ky projektligj është parashikuar për vitin 2018, për përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë të BE-së, dhe në përmbushjen e detyrimit për zbatimin e Konventave ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është Palë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me kuadrin ligjor vendas të fushës së mbrojtjes së natyrës dhe faunës. Gjithashtu sikurse u përmend më lart, nëpërmjet këtij akti do të bëhet përafrim më i plotë me dy direktivat, të shpendëve dhe atë të habitateve.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Rregullat e përgjithshme të legjislacionit të BE-së që lidhen me mbrojtjen e faunës së egër janë transpozuar tashmë në një masë mbi 95% dhe janë përfshirë në legjislacionin tonë për natyrën dhe biodiversitetin.

Projektligji synon transpozimin e mëtejshëm të *acquis communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nëpërmjet të këtij projektligji janë parashikuar ndërhyrje për shtesa e ndryshime thuajse në të gjithë krerët e ligjit ekzistues nr. 10006/2008.

Së pari është propozuar që të ketë një ndryshim që në titull të ligjit ekzistues, duke përfshirë termin *konservim*. Kjo për arsyen se në të dy direktivat e BE të cituara më sipër, ky koncept është i shumëpërdorur. Direktiva nr. 2009/147/ EC e BE që në titull shprehet '*mbi konservimin e shpendëve të egër*' dhe në paragrafin e parë të nenit 1 ka të shprehur që '*Kjo direktivë lidhet me konservimin e të gjitha specieve të shpendëve të egër...*', terminologji që e gjejmë dhe në brendi pastaj në nene të ndryshme të direktivës. Po kështu dhe në direktivën tjetër të habitateve, në shumë nene të saj, kemi konceptin e konservimit.

Mbi këtë bazë në nenin 1 të projektligjit është propozuar që ligji aktual i faunës së egër të marrë emërtimin "Për mbrojtjen dhe konservimin e faunës së egër".

Koncepti i konservimit, është përfshirë më tej në nenin 4 të projektligjit, sikurse dhe në nene të tjera në këtë akt.

Ndërkohë që në fillim të projektligjit, nëpërmjet nenit 2, janë reflektuar ndryshimet institucionale dhe transferimi i kompetencave që janë bërë gjatë kësaj periudhe, sikurse dhe paraqitja me fushat përkatëse ligjore të çështjeve të caktuara.

Nenet 3 dhe 4 të projektligjit paraqesin gjithashtu ndërhyrje në Kreun I, të ligjit bazë, duke sqaruar më tej qëllimin dhe synimet e ligjit, sikurse dhe shtesa dhe ndryshime në përkufizimet e dhëna në ligjin bazë 10006/2008.

Ndryshimet e bëra në disa nene të Kreut II të ligjit bazë, kanë të bëjnë si me forcimin e synimeve dhe kërkesave të mbrojtjes (nenet 5 dhe 6 të

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar"

projektligjit), ashtu dhe me shtimin e një neni 6/1 që lidhet me masat e mbrojtjes për zonat me interes për komunitetin europian, për të mundësuar kështu një efektivitet më të madh në mbrojtjen e faunës së egër por dhe të habitateve të saj. Po në këtë linjë shkojnë dhe shtesat që janë propozuar në nenin 8 dhe 9. Ndërsa nëpërmjet nenit 10, është mundësuar dhe një përafrim i mëtejshëm në kuadër të detyrimeve ndërkombëtare që kemi.

Ndërhyrjet me dy nenet 11 dhe 12, saktësojnë më tej ato çfarë janë parashtruar në nenet respektive të Kreut III, të ligjit bazë.

Po ashtu dhe nenet 13, 14, 15 dhe 16 të projektligjit, saktësojnë më tej se si do procedohet lidhur me sa kërkohet në nenet respektive.

Në Kreun VII të ligjit nr. 10006/2008 është parashikuar përfshirja e një neni të ri, 35/1 (17 në projektligj), nëpërmjet të cilit planifikohet ngritja e Këshillit Kombëtar të Faunës së Egër, si një strukturë me disa attribute këshillimore që parashikohet të kontribuojë në lehtësimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore të tij. Po në këtë Kre, është parashikuar dhe një rregullim në nenin 37 pika 1 të ligjit.

Neni 19 i projektligjit bën një plotësim në nenin respektiv të ligjit bazë 39 në Kreun VIII.

Po ashtu dhe nenet 20 dhe 21 të projektligjit bëjnë plotësime dhe shtesa të nevojshme në nenet respektive në Kreun IX dhe të fundit të ligjit nr. 10006/2008.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Duke qenë një akt që lidhet me punën e disa strukturave, për zbatimin e tij krahas Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit do të punojnë edhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit (si agjencia përgjegjëse për monitorimin e mjedisit), strukturat inspektuese si dhe njësitë e qeverisjes vendore së bashku me strukturat e tyre të kontrollit.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektvendim është hartuar nga ana e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, mbi bazën e mbështetjes që ka dhënë projekti për sistemin e monitorimit mjedisor i GEF/UNDP.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Relacion shpjegues për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10006, datë 23.10.2008 "Për mbrojtjen e faunës së egër", të ndryshuar"

Ky projektvendim nuk do të ketë efekte shtesë financiare në buxhetin e shtetit, pasi implementimi i tij nuk do të kërkojë financime shtesë.

MINISTRI
Blendi KLOSI

